



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 16-25015/2015
Kaçanik, 31. 07. 2015

Në mbështetje të nenit 51.3 dhe 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 -Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 31 korrik, 2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE
FINANCA

1. Me këtë Vendim, Avni Tafili, caktohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), në vend të Hajdar Lokut.
2. Caktimi i anëtarit si në pikën 1. të këtij Vendimi bëhet pasi që anëtar i mëparshëm, Hajdar Loku, është tërhequr nga ky komitet me dëshirën e vet.
3. Mandati i anëtarit nga pika 1. e këtij Vendimi është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës, ndërsa fillon nga dita e caktimit të tij në KPF-a.
4. Anëtar i përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi do t'i ushtroj të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si në dispozitat ligjore që e rregullojnë çështjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; Kryetari i Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Avni Tafili, Hajdar Loku, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Komiteti për Politikë dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi.



Kryesuesi i kuvendit
Xhelal Gashi